

RAPORTI VJETOR

Milieukontakt Shqipëri
Drejt një shoqërie të qëndrueshme

20
23






Tabela e përmbajtjes

01

Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive

Angazhimi ynë kombëtar përkrah shoqërisë civile
Angazhimi ynë ndërkombëtar

02

Zhvillimi i qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në Mirditë përmes
promovimit të trashëgimisë kulturore

03

Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh

Mbështetje në nivele të ndryshme për përmirësimin e
efiçencës së energjisë në ndërtesat në Kosovë dhe
Shqipëri
Ngritja e pesë komuniteteve të energjisë së
rinovueshme në Bashkinë Përmet

04

Mjedisi dhe shëndeti

Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër
varfërisë energjitike në Mesdhe
Ajër i pastër, jetë e shëndetshme
Shkolla ime riciklon
Menaxhimi i riskut në sektorin e ujit, higjenës dhe
mikroplastikës në rajonin e Ballkanit
Iniciativa përdor më pak plastikë
Monitorimi i nivelit të mërkurit në Parkun Kombëtar të
lumit Vjosa



05

Politika dhe Legjislacioni Mjedisor

Trajtimi i plastikës njëpërdorimshe në rajonin e Adriatikut nëpërmjet veprimeve publike dhe private Komunitete e energjie të drejta për gjinitë dhe shoqërinë Shqiptare



06

Shikueshmëria dhe Media




07

Vizioni i së ardhmes



08

Transparenca dhe pasqyrat financiare



Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive

Valbona MAZREKU

Milieukontakt Shqipëri është një organizatë jo qeveritare që synon përmirësimin e cilësisë së jetesës nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, shfrytëzimit të qëndrueshëm dhe shtimit të burimeve natyrore, nxitjes së përgjegjshmërisë, solidaritetit, pjesëmarrjes aktive në vendimmarrje, bashkëpunimit dhe përfshirjes sociale, për një të ardhme të qëndrueshme. Përgjatë vitit që lamë pas, ekipi i Milieukontakt Shqipëri aktivisht ka punuar për zbatimin e mbi 11 projekteve si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si drejtuese por edhe në bashkëpunim me organizata të tjera. Shumë sfida dhe zhvillime sociale dhe politike kemi hasur në rrugëtimin tonë, por që na kanë forcuar dhe motivuar për të vazhduar më tej në përpjekjet për të përfaquar dhe mbrojtur kauzat e ndryshme mjedisore.

Njohja e punës dhe arritjeve tona nga institucionet ndërkombëtare, pjesëmarrja për të ndarë eksperiencat dhe artikuluar sfidat në forume të ndryshme ndërkombëtare janë një shpërblim mëse i merituar për të gjithë stafin dhe punën e palodhur me komunitetet vendore për të zgjidhur së bashku problemet, por edhe për të rekomanduar ndryshime në politika sa më mjedisore.

Viti 2023, ishte një vit i mbarë në fushën e energjisë duke na përfshirë dhe renditur përkrah shumë organizatave të tjera në mbrojtje dhe advokim të demokratizimit të sektorit të energjisë, sa më të drejtë për gjininë dhe grupet e ndryshme shoqërore. Fuqizimi i grave dhe i grupeve vunerabël ka qenë gjithmonë në fokusin tonë për të adresuar varfërinë energjitike por edhe duke ofruar mjete për të qenë prosumatorë (prodhues dhe konsumator) të energjisë së rinovueshme.

Cilësia e ajrit dhe e drejta për t'u informuar e për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm ka qenë në vëmendjen tonë, duke konsoliduar sistemin e monitorimit alternativ për disa nga parametrat e ndotjes së ajrit, por edhe duke shërbyer si burim informacioni për botën akademike, median dhe përmes tyre edhe për qytetarët shqiptarë. Gjithsesi mbetet të punohet edhe më tej për të sjellë fakte dhe të dhëna më të plota mbi ndikimin aktual dhe atë të pritshëm në shëndet.

Milieukontakt Shqipëri gjithmonë ka mbështetur nismat ndërkombëtare, si ajo "Përdor më pak plastikë", përpjekje e përbashkët me GIZ, MedWave për të ndihmuar bizneset HORECA (Hotele, Restorante, Kafene) për të reduktuar dhe parandaluar përdorimin e plastikës një përdorimshe (P1P). Përdorimi i aplikacioneve digjitale sjell më pranë ekspertët e mjedisit me bizneset duke ofruar alternativa të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin dhe certifikime ndërkombëtare.

Milieukontakt Shqipëri përmes shembullit dhe aktiviteteve të zbatuara mbështet, inkurajon dhe ndihmon që të jemi kolegë më të mirë, qytetarë më të mirë, e të ndërtojmë një shoqëri më të qëndrueshme e neutrale ndaj klimës.

Angazhimi ynë kombëtar përkrah shoqërisë civile

Angazhimi ynë kombëtar është thelbësor për të zhvilluar një mjedis të qëndrueshëm dhe për të adresuar sfidat mjedisore në nivel lokal dhe kombëtar. Shoqëria civile, duke përfshirë organizatat mjedisore, luan një rol kyç në mbrojtjen e mjedisit dhe në nxitjen e veprimeve të qytetarëve për të promovuar ndryshime pozitive në mjedis. Thënë këtë, bashkëpunimi mes qeverisë dhe shoqërisë civile është i rëndësishëm për të adresuar problemet mjedisore dhe për të ndërmarrë masa efektive. Kjo përfshin krijimin e partneriteteve të ndryshme dhe bashkëpunimin për zhvillimin e politikave, monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe sensibilizimin e opinionit publik në lidhje me çështjet mjedisore.

Në këtë kontekst, angazhimi ynë kombëtar për të përkrahur shoqërinë civile përfshin ekspertizë, ofrimin e burimeve të nevojshme, si dhe mbështetje nga partnerët tanë ndërkombëtar. Këto masa përbëjnë një pjesë të angazhimit tonë kombëtar për të përmirësuar gjendjen e mjedisit dhe për të ndihmuar shoqërinë civile të luajë rolin e saj të rëndësishëm në këtë drejtim.

Edhe gjatë vitit 2023, Milieukontakt ka qenë pjesë e angazhimeve të ndryshme të OSHC-ve mjedisore kombëtare në mbrojtje të zonave të mbrojtura dhe ruajtje ato nga ndërhyrjet për investime infrastrukturore. Zonat e mbrojtura janë pasuri kombëtare dhe vendimmarrja për këto zona duhet t'i nënshtrohet kuadrit ligjor në fushën e planifikimit të territorit, ligjit për zonat e mbrojtura, ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit, ligjin për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ligjeve të tjera në fusha specifike. Që në krye të herës, grupimi i organizatave dhe ekspertët u ngritën kundër ndryshimeve të propozuara nga parlamenti. Draft ligji për ligji tjetërsimin e zonave të mbrojtura (ZM), legjitimitimin e gjithë ndërtimeve e ndërhyrjeve të paligjshme në zona të mbrojtura dhe miratimin e çfarëdo investimi të ashtuquajtur strategjik në zemër të zonave të mbrojtura. Grupimi i organizatave i kanë kërkuar parlamentit e qeverisë të tregojnë transparencë, të hapin procesin për këshillimin e duhur mjedisor si dhe të dëgjojnë argumentet e organizatave, institucioneve akademike dhe shkencore dhe partnerëve ndërkombëtarë në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Ndotja sot është një sfidë globale dhe karakteristike e ekonomive apo vëndeve në zhvillim, si Shqipëria, të cilat u japin prioritet aktiviteteve me përfitim të lartë ekonomik por në kurriz të shfrytëzimit të resurseve apo mjedisit në tërësi për shkarkimin e eksternaliteteve. Në mungesë të monitorimeve, inspektimeve, gjurmimit të ndotjes apo masave për reduktimin e saj në një kohë kur as nuk dihet më cilat janë zonat e nxehta, Milieukontakt së bashku me organizata vendore kanë marrë pësupër që në mënyrë alternative dhe të bazuar në fakte të informojnë publikun, median sikundër edhe autoritetet në lidhje me rezultatet që gjenerohen nga praktikat e monitorimit në terren të cilësisë së ajrit urban. Rrjeti ka sjellë në vëmendje problemet shëndetësore të banorëve dhe privimin e së drejtës për të jetuar në një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm.

“Ne jetojmë në një kohë sfidash mjedisore të paprecedentë. Krizat e shumta që lidhen me ndryshimet e klimës, humbjen e biodiversitetit dhe ndotjen e përhapur po ndikojnë në gëzimin e të drejtave të njeriut dhe po rrezikojnë arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kemi ende shumë për të bërë, për të shpëtuar qindra e mijëra jetë çdo vit”.

Angazhimi ynë ndërkombëtar

Modeli ynë ekonomik sot është tepër i varur nga përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve natyrore. Sipas Kombeve të Bashkuara, nxjerrja dhe përpunimi i burimeve natyrore është shkaku i gjysmës së emetimeve globale të gazeve serrë dhe 80 deri në 90 për qind të humbjes së biodiversitetit. Vetëm nëntë për qind e materialeve të prodhuara nga njeriu mbeten në qarkullim. Koha po mbaron. Ne kemi nevojë për një reagim të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe të shpejtë ndaj këtyre sfidave. Nuk mund të vazhdojmë me modelet tona tradicionale ekonomike dhe të konsumit. Nuk ka planet B.

Përballja me këto sfida kërkon bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar. Disa nga projektet e Milieukontakt kanë patur karakter rajonal me komponent mjaft të fortë bashkëpunimi dhe ndarje eksperiencash mes organizatave të ndryshme, duke ndërtuar dhe përfituar nga mësimet e nxëna. Në mars të 2023 Milieukontakt mori pjesë në Konferencën e OKB për Ujin si pjese e rrjetit WMG (Women Major Group) duke diskutuar mbi sfidat për arritjen e OZHQ 2030 dhe ndalur konkretisht në praktikën e mira të bashkëpunimit mes aktorëve dhe mirëmenaxhimit të ujërave ndërkufitar.

Milieukontakt Shqipëri ishte një ndër organizatorët e dialogut politik në Parlamentin Evropian për Varfërinë Energjitike. Në kuadër të projektit [EmpowerMed](#) u zhvillua dialogu politik në [Bruksel](#) me mbështetjen e Parlamentares Spanjolle Znj. Gálvez Muñoz. Dialogu prezantoi lidhjen ndërmjet varfërisë energjitike, gjinisë dhe shëndetit në zonën e Mesdhit. Pas fuqizimit të më shumë se 4,000 familjeve të prekura nga varfëria energjitike, projekti është duke dialoguar me vendimmarrësit e 7 vendeve evropiane se si të koordinohen politikat dhe masat për të trajtuar varfërinë energjitike, përmirësuar shëndetin e grupeve vulnerabël dhe mbështetur gratë. Ndryshimet klimatike dhe burimet e rinovueshme të energjisë kanë qenë në vëmendje të aktiviteteve të zbatuara nga Milieukontakt në partneritet me organizata nga rajoni dhe Evropa perendimore. Pjesëmarrja në forume dhe takime ndërkombëtare na ka dhënë mundësi jo vetëm të sjellim eksperiencat tona, por edhe të krijojmë partneritete të reja. Ne besojmë se OSHC-të mjedisore mund të luajnë një rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit, duke ofruar advokim të bazuar në informacion dhe si mbikëqyrës të politikave dhe strategjive. Ndaj Milieukontakt është e angazhuar për të ndihmuar në ndarjen e informacionit, rritjen e njohurive dhe advokimin për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe mundësuar një mjedis për zhvillimin e komuniteteve të para të energjisë së rinovueshme.

Plastika, reduktimi i saj në paketimet e produkteve të ndryshme si dhe promovimi i praktikave të riciklimit apo ripërdorimit, si pjesë e strategjisë botërore për reduktimin e mbetjeve plastike, ka qenë pjesë e angazhimeve të Milieukontakt Shqipëri me partnerë ndërkombëtar. Iniciativa “Përdor më Pak Plastikë” synon të ndërtojë një komunitet biznesesh vizionare të përkushtuar për uljen graduale të përdorimit të produkteve plastike njëpërdorimëshe që gjenden më shpesh gjatë aksioneve të pastrimit në vendet e Ballkanit Perendimor.

Milieukontakt është pjesë aktive e disa rrjeteve ndërkombëtare që operojnë në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së lumenjve, barazisë gjinore, etj (si WMG, IHPN, GAIA, YEE, EEB) dhe së bashku me to ngre problematikat mjedisore që të jenë më mirë të pasqyruara në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të detyrojë qeverinë të jetë më e përgjegjshme në angazhimet e saj për një mjedis të sigurtë, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

2023 NË SHIFRA

Bashkëpunëtorët 193

Ekspertët 53

Nxënës dhe studentë 490

Bashki 29

Mësuesit 64

Qytetarët 3719

Donatorët 12

Projektet e zbatuar 11

Botimet 12

ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në
Mirditë përmes promovimit të
trashëgimisë kulturore.

Mars 2023 –2024



Ky projekt do të zhvillojë mundësitë socio-ekonomike dhe kulturore si një mjet për rigjallërimin e komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik lokal. Aktivitetet në këtë projekt do të promovojnë kulturën, traditat dhe vlerat natyrore të zonës, të cilat do të bëhen të aksesueshme për publikun dhe turistët dhe mbi të gjitha duke kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik.

Aktivitetet e projektit kanë për qëllim prezantimin e rolit të trashëgimisë kulturore para publikut si një shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik, gjithashtu për të përfshirë autoritetet publike, modele gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme gjinore si dhe për të forcuar kapacitetet profesionale të individëve, grupeve lokale që punojnë për trashëgiminë kulturore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin.

Partnerë

Bashkia e Mirditë

Donatorë

Programi EU4Culture, financuar nga BE, zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës.

Rezultatet:

- Identifikimi i aftësive ekzistuese dhe të humbura, boshllëqeve dhe burimeve në fushën e artit, artizanatit (gdhendje në gur dhe dru, pirografi, qëndisje, artizanat me bakër, punime kashte dhe veshje tradicionale) dhe shërbimet turistike duke përfshirë gratë dhe të rinjtë e zonave rurale.
- 4 module trajnimi të përgaditura për çdo kurs profesional (shërbim turistik, qëndisje, pirografi, guidë turistike);
- 4 shtigje natyrore të pastruara dhe të markuara;
- 109 pjesëmarrës përfshirë dhe të rinj morën pjesë në kurset profesionale 5 ditore (61 gra);
- Së paku 15 vajza të reja filluan të prodhojnë punime me dorë duke përdorur simbole tradicionale;
- 23 biznese të vogla dhe potenciale u trajnuan se si të zhvillojnë biznesin e tyre duke marrë parasysh turizmin e qëndrueshëm (17 gra);

QEVERISJE DEMOKRATIKE DHE NDËRTIM KAPACITETESH

Mbështetje në nivele të ndryshme për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat në Kosovë dhe Shqipëri - RenovAID

Tetor 2023 - shtator 2025



Projekti “Mbështetje në nivele të ndryshme për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesat në Kosovë dhe Shqipëri” adreson çështjen e përmirësimit të efikasitetit energjetik të ndërtesave duke ofruar mbështetje në shumë nivele vendimarrje. Rëndësia e efikasitetit të energjisë në tranzicionin e energjisë, ndihmon në përballueshmërinë, sigurinë e furnizimit dhe veprimet ndaj klimës. Meqenëse mungojnë kornizat adekuate të politikave, renovAID synon të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse në këtë aspekt të tranzicionit energjetik dhe objektivi është të lehtësojë krijimin e politikave në mbështetje të efikasitetit të energjisë dhe masave me ndikim - përfshirë Çertifikatën e Performancës së Energjisë dhe pika me një ndalesë për rinovimin e shtëpive.

Partnerë

WiseEuropa; Energiaklub; INDEP; BGF

Donatorë

Ministria Federale e Çështjeve ekonomike dhe veprimeve për klimën në Gjermani, zbatuar nga programi EUKI

Rezultatet:

- Rregullator: rritja e kapaciteteve të administratave publike në Kosovë dhe Shqipëri për të krijuar politika të efikasitetit të energjisë që është e favorshme dhe e harmonizuar me rregulloren e BE-së.
- Informimi: pajisja e administratës publike me aftësitë e nevojshme për krijimin e bashkëpunimit ndërsektorial me aktorë të tjerë dhe nisjen e fushatave efektive të informacionit.
- Stimulimi: trajnimi i grupeve të synuara për ngritjen e dyqaneve me një ndalesë, të cilat ofrojnë stimuj për pronarët e ndërtesave për të kryer rinovimin. Arsyeja pas kësaj qasjeje është se çështjet kryesore të identifikuar në vendet e synuara kërkojnë mbështetje gjithëpërfshirëse dhe sistematike – veprime që jo vetëm do të eliminojnë barrierat ekzistuese, por edhe do të stimulojnë ndryshimin.

Ngritja e pesë komuniteteve të energjisë së rinovueshme në Bashkinë Përmet

Dhjetor 2023 - Korrik 2024



Ky projekt synon të përgatisë kushtet për ngritjen e pesë Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme në bashkinë e Përmetit me synim parësor gjenerimin e energjisë diellore për të ulur kostot aktuale të energjisë elektrike për funksionimin e pompave të ujitjes.

Stacionet e pompimit janë në 5 fshatra dhe prej disa vitesh, këto stacione pompojnë ujë sipërfaqësor nga lumi Vjosa me një kapacitet rreth 40-80 litra/sekondë.

Projekti do të hartojë një studim fizibiliteti që do të shërbejë për të zgjuar interesin e donatoreve dhe institucioneve financiare për të përmirësuar dhe modernizuar sistemin e ujitjes duke përdorur energjinë e rinovueshme nga panelet Fotovoltaike. Padyshim investime të tilla do të ndihmojnë fermerët që së bashku me bashkinë të kthehen në prodhues dhe konsumues të energjise.

Partnerë

Bashkia Përmet

Donatorë

SECO – Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike në Zvicër


Rezultatet:

- Saktësimi i kriterëve ligjore për ngritjen e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
- Përgatitja e udhërrëfyesit për angazhimin dhe mobilizimin e qytetarëve në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme.
- Përshkrimi i organigramit, rolet dhe përgjegjësitë, pronësia e aseteve, flukset financiare brenda Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme.
- Analizat Teknike/Energjiko-Ekonomike të stacioneve të pompimit dhe sistemeve të ujitjes.

Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe

Shtator 2019 - Gusht 2023



 Jemi krenarë që projekti EmpowerMed u shpall fitues i çmimit Inovacioni Social Evropian për 2023! Koncepti i mbledhjeve kolektive si përfaqje për të adresuar varfërinë energjitike mbështetet në inteligjencën kolektive të grupeve duke angazhuar individët në mbështetje të personave që vuajnë nga varfëria energjitike. Tashmë fokusi është përhapja e këtij koncepti dhe adresimi i varfërisë energjitike në të gjithë Evropën.

Projekti adreson sfidat e varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave. Zonat bregdetare të Mesdheut hasin një sërë sfidash në lidhje me varfërinë energjitike, fenomen që haset edhe në banesa. Ndërtesat rrallë janë të izoluara, shpesh pa sistem ngrohje, ose jo efikas. Një element tjetër i varfërisë energjitike në këto zona lidhet edhe me ftohjen e banesave. Në përgjithësi është vërejtur se varfëria energjitike prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe familjet e drejtuara nga gratë, të cilat janë aktori më i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë së energjisë. Projekti do të trajtojë specifikisht edhe ndikimin e varfërisë energjitike në shëndetin e njeriut. Do të vlerësohen gjithashtu dhe masat e rekomandimet që mund të zbatohen në nivel politik, duke advokuar dhe adresuar politikat dhe masat për varfërinë energjitike.

Partnerë

DOOR, SOGESCA, UAB, IREC, GERES, WECF, ESF koordinuar nga Focus.

Donatorë

Komisioni Evropian, Programi HORIZON 2020

Rezultatet:

- Krijimi i rrjetit me aktorët lokal në zonën e Mesdheut (Shqipëri, Spanjë, Francë, Itali, Slloveni, dhe Kroaci) duke kaluar njohuritë e eksperiencave thelbësore për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në zbatimin e masave praktike.
- Masa praktike, për të adresuar varfërinë energjitike (qasje në komunitet, vizita në banesa, mbështetje me investime të vogla, workshop për personelin mjekësor në Bashkinë Vlorë.
- Advokim në nivel kombëtar dhe Evropian për promovimin e politikave që adresojnë varfërinë energjitike.

Ajër i pastër, jetë e shëndetshme

Maj 2022 - maj 2023



Ndotja e ajrit në vendin tonë është një problematikë të cilës i duhet dhënë vëmendja e duhur nga institucionet përgjegjëse dhe të merren masa emergjente. Pikërisht këtë synon edhe projekti “Ajër i pastër, jetë e shëndetshme”, duke krijuar rrjetin kombëtar të OJF-ve, i cili do të adresojë problematikat që lidhen me cilësinë e ajrit, përmes monitorimit alternativ, analizimit dhe advokimit, si dhe për të vleftësuar të drejtën për informacion mbi procesin e vendimmarrjes që ndikon në cilësinë e ajrit.

“Gjatë marrjes së anamnezës së jetës i pyesim pacientët në lidhje me ambientin në të cilin jetojnë, si dhe u flasim për ndikimin në shëndet të ajrit të ndotur” - na thotë një mjek familje.

Partnerë

Qendra EPER, Together for Life, GO2

Donatorë

Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim zbatuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me CISP Sviluppo dei Popoli, VIS Albania dhe COSV – Cooperazione per lo Sviluppo”.

Rezultatet:

- Rrjeti i OJF-ve marrin pjesë dhe kontribuojnë në përmirësimin e kuadrit rregullator në nivel vendor dhe kombëtar për një cilësi më të mirë ajri dhe brenda standarteve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.
- Rrjeti funksional i OJF-ve mjedisore mbi cilësinë e ajrit aktiv dhe pas mbarimit të projektit.
- Përditësim njohurish e informacioni për grupe të ekspertëve, politikbërësve, vendimmarrësve, mediave, OJF-ve dhe qytetarëve, në fusha të ndryshme multidisiplinare (industri, transport, shëndetësi) lidhur me cilësinë e ajrit.
- 1000 stacione monitorimi alternativ për 4 parametra (PM2.5, PM10, CO2, NO2) të cilësisë së ajrit në 5 qytete kryesore dhe përditësimi i platformës www.greenlungs.al.

Shkolla ime riciklon

Nëntor 2022 – maj 2023



“Shkolla ime riciklon”, është pjesë e programit “Kryeqytetet që bashkëpunojnë për sfidat e përbashkëta në menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme – Yerevan, Varshavë, Tiranë”. Për shkak të rritjes së shpejtë të popullsisë në vazhdimësi, e cila reflektohet në zhvillimin e ndërtimit në sektorin e shërbimeve, bashkia e Tiranës duhet të përballë me probleme mjedisore, që lidhen me menaxhimin e mbetjeve, rikuperimin e materialeve të riciklueshme, mbetjet e vetme plastike. Pjesë përbërëse e menaxhimit të mirë të mbetjeve është informimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve të shkollave fillore “Pjetër Budi” dhe nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri”. Disa prej aktiviteteve që do të zbatohen në bashkëpunim me të dyja shkollat do të fokusohen në prezantimin e skemës pilot për ndarjen e mbetjeve urbane dhe të rrezikshme; aktivitete ndërgjegjësuëse në komunitet nëpërmjet takimeve derë më derë; konkurse mbi videon promovuese dhe informuese si dhe punë krijuese artistike.

Partnerë

Shkolla 9 vjeçare Pjetër Budi, Gjimnazi Sami Frashëri, Bashkia Tiranë

Donatorë


Bashkia Tiranë, Financuar nga Bashkimi Europian.

Rezultatet:

- Informimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve dhe komunitetit për menaxhimin e mbetjeve;
- Prezantimi i skemës pilot për ndarjen e mbetjeve urbane;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, komunitetit dhe shoqërisë civile.
-

Menaxhimi i riskut në sektorin e ujit, higjienës dhe mikroplastikës në rajonin e Ballkanit

Mars 2023 - shkurt 2025



Aktivitetet e projektit zhvillohen në Rumani, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Serbi, ku ka mungesa për sigurinë e ujit dhe menaxhimin e higjienës në zonat rurale, situatë që mund të shkaktojë pasoja serioze për mjedisin dhe shëndetin e popullatës. Qëllimi ynë është të përshtasim e të zhvillojmë më tej instrumentin e Ujit dhe Planifikimin e Sigurt të Higjienës (WSSP). Projekti zhvillon metoda për analizën e riskut dhe vlerësimin e ujit e higjienës, duke treguar masat që mund të merren për të minimizuar riskun dhe për të përmirësuar situatën.

“Uji është burimi i jetës ndaj duhet të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë dhe vlerën e ujit. Jo vetëm ne, por edhe brezat e ardhshëm. Përkushtimi ynë për të ruajtur burimet ujore dhe për tu kujdesur për cilësinë e tyre është një detyrim moral dhe një përgjegjësi ndaj planetit Tokë.”

Partnerë

WECF, Women in Development, Acuadematica, Journalist for Human Rights, Environmental Ambassadors for Sustainable Development

Donatorë


Ministria Federale e Çështjeve Ekonomike dhe Veprimeve për Klimën në Gjermani

Rezultatet:

- Kualifikimi / trajnimi i 20 mësuesëve
- Kualifikimi / trajnimi i 30 nxënësve
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi për higjienën, praktikat e mira dhe konsumit të ujit të pastër nëpërmjet institucioneve të arsimit; nxënësve dhe mësuesve.
- Publikimi i "Water Classroom" si material ndihmës mësimor për mësuesit e shkollave 9 vjeçare duke i bërë orët mjaft praktike përmes eksperimenteve.
- Publikimi Stop Plastikës, projektuar për fëmijët dhe të rinjtë në klasat 5-6, 7-8 dhe 9-10.

Iniciativa përdor më pak plastikë

Tetor 2023 - tetor 2024



Objektivi i projektit është të motivojë mbi 700 biznese të sektorit Horeca, hotele, restorante, kafene dhe dyqane të vogla që të ulin përdorimin e plastikës njëpërdorimshe, gjetja e zgjidhjeve alternative më të qëndrueshme dhe evidentimi i përfitimeve që kjo iniciativë do të sjelli tek bizneset që do të ndërmarrin këto masa. Këto biznese do të pëzgjidhen në 14 bashki të Shqipërisë; Tiranë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Belsh, Fier, Berat, Kavajë, Lushnje, Tepelenë, Gjirokastrë, Pogradec dhe Korçë me ndihmën e 9 koordinatorëve lokalë të përcaktuar për këto bashki. 700 bizneset do të pajisen me një deklaratë e cila do të paraqesë angazhimin e bizneseve që do të bëhen pjesë e Inicativës Përdor më Pak Plastikë.

Partnerë
Sektori HoReCa

Donatorë
GIZ Shqipëri

Rezultatet:

- Të paktën 700 biznese HoReCa do të fillojnë të reduktojnë përdorimin e plastikës njëpërdorimshe
- Udhëzues me alternativa miqësore me mjedisin do tu ofrohen bizneseve



Monitorimi i nivelit të mërkurit në Parkun Kombëtar të lumit Vjosa

Korrik 2023 - Shtator 2024



Bazuar në rëndësinë e monitorimit të nivelit të mërkurit në Shqipëri, Milieukontakt do të bëjë një hartë të nivelit të mërkurit në pellgun e Lumit Vjosa. Lumi Vjosa konsiderohet si lumi i fundit i egër në Evropë, për mbrojtjen e tij ka pasur ndjeshmëri në nivel botëror. Përgjatë rrjedhës së tij ka shkarkime të ujërave të zeza (pa trajtim) nga një sërë qendrash urbane, të cilat njihen përgjithësisht për nivelin e lartë të ndotësve. Zona e Memaliajt, duke qenë prej vitesh minierë qymyri, ka kontribuar në depozitim të ndotësve të ndryshëm. Qymyri dihet se përmban metale të rënda dhe mërkur. Lumi Vjosa dhe degët e tij kalojnë pranë qyteteve të Vlorës dhe Fierit, të ekspozuar ndaj aktiviteteve industriale. Vlerësimi shkencor dhe cilësor i ujit të Vjosës, do të ndërgjegjësojë politikën dhe aktorët e tjerë për të mbrojtur dhe ruajtur ekosistemin duke i dhënë statusin më të lartë të Parkut Kombëtar.

Partnerë

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Donatorë

UNDP përmes Global Environment Facility/Small Grants Programi GEF/SGP

Rezultatet:

- Hartëzimi i nivelit të Mërkurit në sedimentet dhe biotën e lumit Vjosa dhe degëve të saj.
- Studim mbi nivelin e Mërkurit në sedimentet dhe biotën e lumit Vjosa.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për ndikimin e mërkurit në shëndet dhe mjedis

POLITIKA DHE LEGJISLACIONI MJEDISOR

Trajtimi i plastikës njëpërdorimshe në rajonin e Adriatikut nëpërmjet veprimeve publike dhe private

Mars 2023 - dhjetor 2023



Produktet plastike njëpërdorimëshe përfshijnë artikuj që përdoren vetëm një herë dhe më pas hidhen ose riciklohen, artikuj si qese plastike, ambalazhe ushqimore, shishe, pipa, enë, gota dhe pajisje tualeti, produktet që përdoren zakonisht nga hotelet, restorantet dhe kafenetë. Pasi përdoret, plastika njëpërdorimëshe rrezikon të kthehet në ndotje për lumenjtë dhe detet, duke çliruar kimikate toksike në to. Iniciativa Përdor më Pak Plastikë synon të ndërtojë një komunitet biznesesh në Himarë të përkushtuar për heqjen graduale të përdorimit të produkteve njëpërdorimëshe që gjenden më shpesh gjatë aksioneve të pastrimit në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Partnerë

MedWaves, Cener21, Zero Waste Montenegro, Green Home, GIZ;

Donatorë

MedWaves, Qendra Rajonale e Veprimtarisë së UNEP/MAP për Konsum dhe Prodhim të Qëndrueshëm

Rezultatet:

Reduktimi i gjenerimit të mbetjeve nga produktet plastike njëpërdorimshme (SUPP) nëpërmjet zbatimit të dy nismave të ndërlidhura dhe plotësuese:

- Nisma "Zonë me pak plastikë" do të ndihmojë bizneset e interesuara në sektorin HORECA të reduktojnë konsumin e SUPP-ve të disponueshme.
- Iniciativa e Prokurimit të Gjellbër, ka potencial të madh për të reduktuar konsumin dhe prodhimin e SUPP-ve. Projekti do të ndihmojë Bashkinë e Himarës të vendosi kritere të gjelbra në procedurat e prokurimit për shërbimet e kateringut, makinat shitëse dhe organizimin e eventeve të mëdha.

Komunitete e energjie të drejta për gjinitë dhe shoqërinë Shqiptare

Dhjetor 2023 - nëntor 2025



Tranzicioni i energjisë paraqet një mundësi të rëndësishme për të adresuar defiçitet gjinore që janë rezultat i drejtpërdrejtë i modelit të centralizuar të energjisë me bazë fosile dhe për të futur parimet e barazisë gjinore në sistemet energjetike. Aksesimi në energji duhet të lidhet me një axhendë që sfidon stereotipet e rolit të grave dhe që avancojnë drejtat, dinjitetin dhe përfshirjen e tyre në rolet të ndryshme si konsumatore, prodhuese, investitore, eksperte, nëna dhe agjente të ndryshimit.

Objektivi final i projektit është që prodhuesit dhe konsumatorët të bëhen 'prosumatorë' dhe të mund të marrin pjesë aktivisht, individualisht ose përmes komuniteteve, në të gjitha tregjet me koncepte të decentralizuara dhe pjesëmarrëse.

Partnerë
WECF Gjermani

Donatorë
DBU

Rezultatet:

- Analiza gjinore e sektorit të energjisë.
- Analiza e procedurave dhe si të përmirësohet praktikisht zbatimi i ngritjes së Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
- Ngritja e kapaciteteve, transferimi i njohurive dhe rrjetëzimi.
- Planifikimi dhe advokimi i zgjidhjeve të politikave për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme me bazë gjinore.



GENDER AND SOCIALLY JUST ENERGY
COMMUNITIES IN ALBANIA

SHIKUESHMËRIA DHE MEDIA

Përgjatë punës së përditshme kemi dokumentuar dhe bërë të dukshëm aktivitetet dhe nismat tona, nëpërmjet të cilave rezultate, gjetje dhe fakte të ndryshme janë ndarë me median vizive, të shkruar dhe atë sociale.

“Nganjëherë fjalët nuk mjaftojnë. Atëherë nevojiten ngjyrat, format, tingujt dhe emocionet”.

Alessandro Baricco

JANAR 2023



Televizioni Scan TV

Arion Sauku

Shqetësimi për ndotjen e ajrit në Tiranë

Qytetet po betonizohen, cilësia e ajrit duhet të jetë prioritet i qeverisë.

[https://www.youtube.com/watch?](https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=Bc1PMO5mtvo&feature=share&fbclid=IwAR0iunsY894hhlpbiIHovVNV6farVzP6qJbMbSozR4W96YzVuEd41KhfZ60)

[app=desktop&v=Bc1PMO5mtvo&feature=share&fbclid=IwAR0iunsY894hhlpbiIHovVNV6farVzP6qJbMbSozR4W96YzVuEd41KhfZ60](https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=Bc1PMO5mtvo&feature=share&fbclid=IwAR0iunsY894hhlpbiIHovVNV6farVzP6qJbMbSozR4W96YzVuEd41KhfZ60)

Televizioni News24

Emisioni Alert


Valbona Mazreku

Vendimi për ndalimin e qeseve plastike, mangësitë dhe futjen e tyre në rrugë informale.

Qeset plastike, Mazreku: Ku “çalon” vendimi dhe pse kemi pak raste shkeljesh të deklaruara - Alert.al



SHKURT 2023



Televizioni EuroNews

Emisioni Good Morning Albania

Valbona Mazreku

Ndotja në Korçë e lartë për shkak të tymit të oxhageve (youtube.com)

A2CN

Arion Sauku

Cilësia e ajrit, informimi mbi ndotjen, a funksionojnë matësat? (youtube.com)



QERSHOR 2023



A2CN

Albana Joxhe

"Ndotja e ajrit në Tiranë, 5 herë mbi normën e lejuar"
([youtube.com](https://www.youtube.com)).

TOP Chanel
Emisioni Shqipëria Live
Arion Sauku

Muzika e lartë çon në pranga 10 persona, banorët të shqetësuar – Shqipëria Live 12 Qershor 2023
([youtube.com](https://www.youtube.com)).



KORRIK 2023



Televizioni EuroNews

Emisioni Good Morning Albania

Valbona Mazreku

Ndotja në Korçë e lartë për shkak të tymit të oxhaqeve
([youtube.com](https://www.youtube.com)).

SHTATOR 2023



VIZION PLUS

Valbona Mazreku

Praktika e tanishme e monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri, nuk është në linjë me kërkesat e #BE-së.

7pa5 - Korça e Tirana me ajrin më të ndotur, ekspertja habit me detajet - Vizion Plus
([youtube.com](https://www.youtube.com)).

DHJETOR 2023



A2CN

Emisioni A2 NEWS

Arion Sauku

Ndotja akustike është një nga kërcënimet më të rënda, por më pak të njohura shëndetësore të kohës sonë. Sipas studimeve të fundit të OBSH, edhe nivelet e moderuara të zhurmës, rrisin rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare, humbje të dëgjimit, vonesa në zhvillim tek fëmijët, depresion dhe ankth.
Nga humbja e dëgjimit tek ankthi, pasojat nga ndotja akustike - Aktualitet (a2news.com)

ARTIKUJ NE MEDIAN E SHKRUAR

Rast sukcesi projekti "Monitorimi i ndotjes akustike në zonat bregdetare" [#Vlorë](#) [#Himarë](#) mbështetur nga Lëviz Albania projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.



#podcastpërmjedisin [#ArionSauku](#)
 #ndikimiinjëriutnëmjedis [#ndryshimeteklimës](#)
 #objektivatezhvillimittëqëndrueshëm
[#MilieukontaktShqipëri](#)



Një iniciativë energjitike në shkallë të vogël në komunitet që synon të tregojë se kooperativat e energjisë mund të lulëzojnë edhe në Shqipëri - Bashkimi i Kooperativave të Energjisë në Evropë i dedikoi një shkrim Piskova Solar Farming. [https://www.rescoop.eu/news-and-events/stories/september-success-story-a-small-solar-power-plant-inspires-change-in-albania?](https://www.rescoop.eu/news-and-events/stories/september-success-story-a-small-solar-power-plant-inspires-change-in-albania?fbclid=IwAR04tFTfkCue43UwdvXz5Y1RjLQdnST75Aw4jIakwtDNt8Tk7qR4E4tEk2U)

Përsiatje nga paneli i konferencës rrjetëzuese me temë: Si mund të forcohen projektet EUKI dhe politika e BE-së zbatimin e Axfordës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor”. Ndarje njohurish, eksperiencash dhe perspektiva të fituara nga puna me OSHC-të dhe organet e tjera qeveritare nga zbatimi i projektit EUCENA. Gjithashtu ne panel u trajtuan dhe mënyrat e mundshme për të fuqizuar bashkëpunimin mes OSHC-ve, BE-së dhe institucioneve publike në zbatimin e Axfordës së Gjellbër për Ballkanit Perëndimor.



BOTIME

Udhëzuesi HoReCa për Zero Mbetje mbështet bizneset në zbatimin e planit të përmirësimit duke ofruar shembuj të zgjidhjeve alternative reale dhe të ndershme për SUPP-të që janë të disponueshme në rajon. Përveç kësaj, udhëzuesi liston avantazhet dhe shqetësimet e secilës zgjidhje, kursimet e kostos që mund të gjenerohen dhe furnizuesit vendas.

Indeksi i Alternativave të Ndershme ndaj Plastikës (HAPI) i zhvilluar nga Save the Med është përdorur për të llogaritur ndikimin mjedisor të produkteve plastike njëpërdorimëshe dhe zgjidhjeve alternative.

Për të lexuar studimin e plotë klikoni linkun:

http://milieukontakt.org/.../06/ONLINE_horeca-guide-ALB.pdf



Hartëzimi i vlerave Kulturore dhe Natyrore të Zonës së Mirditës

Studimi u ndërmor për të kuptuar më mirë dinamikën lokale socio-ekonomike dhe burimet aktuale.

Pavarësisht problematikës dhe sfidave të sektorëve, u evidentuan potencialet e mundshme të zhvillimit të artizanatit dhe turizmit në sektorin ekonomik, social dhe mjedisor në rrethin e Mirditës.



Studim mbi skemat e mbështetjes financiare për energjitë e rinovueshme dhe efijencën e energjisë në Shqipëri

Qëllimi i studimit: Identifikimi i skemave të mbështetjes financiare në nivel kombëtar dhe lokal për energjitë e rinovueshme dhe efijencën e energjisë në Shqipëri.

Studimi është realizuar në kuadër të projektit **Empowermed** "Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe". Projekti adreson sfidën e varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave.

Për të lexuar studimin e plotë klikoni linkun: <https://milieukontakt.org/wp-content/uploads/2023/07/Skemat-financiare-studim-final.pdf>



Rekomandime mbi Varfërinë Energjitike / Energy Poverty Recommendations

Rekomandimet e hartuara në përfundim të projektit EMPOWERMED në nivel (i) integrimi politikash; (ii) gjinie; (iii) sezoni vere; (iv) ndikimi në shëndet. Disa nga rekomandimet më emergjente ishin:

- Përkufizimi i varfërisë energjitike që merr parasysh aspektet gjinore dhe ndërsektoriale
- Ndalimi ligjor i prerjes së energjisë elektrike
- Nisma për fuqizimin e qytetarëve për të vepruar
- Rritja e ndërgjegjësimit për aspektet gjinore dhe ndërsektoriale të varfërisë energjitike
- Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe perspektiva ndërsektoriale mbi varfërinë energjitike

Stop Plastikës: Bashkohuni!

Botimi synon të rrisë ndërgjegjësimin për problemin e plastikës dhe të nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të krizës së plastikës, nga prodhimi deri te asgjësimi. Ky botim mund të ndihmojë në përhapjen e njohurive rreth substancave të dëmshme në produktet plastike dhe si të shmangim plastikën, duke mbrojtur kështu mjedisin dhe shëndetin tonë.

Ai mund të përdoret nga edukatorët dhe kushdo që punon me fëmijë dhe të rinj për të rritur kujdesin ndaj tyre. Është projektuar për fëmijët dhe të rinjtë nga moshë njëmbëdhjetë deri në gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe është i përshtatshëm për klasat 5-6, 7-8 dhe 9-10.

Raporti vjetor për gjendjen e ajrit urban 2022-2023 në 5 bashki, #Tiranë #Durrës #Elbasan #Korcë #Shkodër


Ky raport ofron një përmbledhje të të dhënave për cilësinë e ajrit, shkarkimet në ajër, institucionet përgjegjëse si dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes aktuale. Për të lexuar raportin e plotë klikoni linkun më poshtë

<https://milieukontakt.org/.../Raport-mbi-cilesine-e-ajrit...>

Raporti përmbledhës i ecurisë për vitin 2021-2022

Çdo vit raporti na jep mundësi të vlerësojmë ndikimin e punës tonë dhe suksesin e iniciativave gjatë vitit të kaluar, si dhe të ndajmë këto arritje me grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

Për të lexuar raportin e plotë klikoni linkun: <https://milieukontakt.org/.../Milieukontakt-raporti-final...>



VIZIONI I SË ARDHMES

Milieukontakt Shqipëri ndërmer partneritete për të përmirësuar cilësinë e jetës, duke rritur pjesëmarrjen e njerëzve dhe shoqërive për një zhvillim të qëndrueshëm.

Milieukontakt bashkëpunon me partnerë (ndër)kombëtarë, sepse problemet mjedisore nuk kanë kufi. Shumë nga sfidat aktuale mjedisore janë mbarë botërore. Në nivel lokal njerëzit mund të mbështeten dhe të mësojnë nga përvojat e të tjerëve që punojnë me të njëjtat probleme në pjesë të tjera të botës. Milieukontakt lidh njerëzit, organizatat dhe rrjetet që merren me të njëjtat sfida dhe duan të bashkëpunojnë drejt rritjes së pjesëmarrjes qytetare në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Milieukontakt do të sigurojë njerëzit me mjetet dhe aftësitë për të përdorur mundësitë për pjesëmarrje, duke përfshirë trajnimin, këshillimin (ligjor) dhe asistimin. Proceset vendimmarrëse me pjesëmarrje janë thelbësore në këto partneritete. Milieukontakt fokusohet në ofrimin e mjeteve për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe zbatimin e projektit.

Ngritja e kapaciteteve Të jesh një mjedisor do të thotë të mësosh gjatë gjithë jetës dhe kjo e bën çështjen interesante dhe sfiduese! Për të qenë efektive, një lëvizje mjedisore kërkon një sërë aftësish që nuk mësohen lehtësisht në shkollë apo në universitet. Mjedisorët duhet të dinë për gamën e gjerë të çështjeve të mbuluara nga ‘mjedisi’. Energjia, ndryshimet klimatike, mbeturinat, menaxhimi i ujit, kanalizimet, kimikatet dhe bujqësia janë disa nga çështjet. Mjedisori duhet gjithashtu të jetë në dijeni të zhvillimeve në qarqet shkencore dhe politike. Sot, çdo gjë lidhet me ndryshimin e klimës dhe atë që do ose nuk do të sjellë në të ardhmen. Ndaj njohuritë duhen përditësuar për të qenë një partner me qeveritë dhe palët e tjera të interesuara. Përveç njohurive mbi çështjet globale, duhet ditur se çfarë po ndodh në vendin, rajonin, qytetin apo fshatin për veprime më efektive. Kjo do të thotë që mjedisorët vazhdimisht mësojnë dhe përshtatin njohuritë shkencore me punën e tyre të përditshme. Ata duhet t’i përkthejnë këto njohuri në politikë dhe veprime. Aftësitë e komunikimit janë thelbësore, siç janë ekspertiza ligjore dhe aftësitë negociuese. Ndonjëherë duhet t’i drejtohem gjykatës ose të negociojmë nëse, nuk ka ndonjë mënyrë tjetër. Ka shumë fusha të tjera në të cilat mjedisorët duhet të përgatiten për t’u bërë efektive; p.sh si të jenë administrator të mirë, projektues, drejtues projekti, profesionist dhe të dinë se si të mundësojnë financimin e të gjitha punëve.

Përfshirja e qytetarëve Nuk ka pothuajse asnjë fushë përveç politikës mjedisore në të cilën përfshirja e qytetarëve është kaq e rëndësishme për suksesin e politikës qeveritare. Shumë çështje politike kanë të bëjnë me çështje të tilla si: sjellja, diferencimi i mbetjeve, lëvizshmëria, ruajtja e energjisë dhe mbrojtja e natyrës. Këto janë të gjitha fusha politike që mund të mbështeten nga instrumentet teknike dhe ligjore, por që në fund gjithmonë bazohen në mbështetjen e qytetarëve dhe në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes. Milieukontakt zhvilloi metodologji për të frymëzuar qytetarët për të zhvilluar “Axhendën e Gjelbër” të tyre dhe, jo vetëm për t’u përfshirë në hartimin e politikave, por edhe për të qenë proaktive.

Zgjidhja e problemeve mjedisore Gjithçka që ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme. Për të arritur qëndrueshmërinë, duhet të zgjidhen problemet ekzistuese mjedisore dhe të zhvillohen koncepte (djep për djep), metoda (riciklimi) dhe mjete (pajisje me energji të ulët), për të parandaluar probleme të reja. Ndërtimi i kapaciteteve dhe përfshirja qytetare pa punuar në drejtim të zgjidhjes së problemeve nuk ka vlerë në arritjen e qëllimit.

STRATEGJIA

Milieukontakt nuk mund të arrijë e vetme misionin e saj. Ne jemi pjesë e rrjeteve formale dhe joformale të njerëzve dhe organizatave që punojnë drejt përmbushjes së misionit tonë. Aftësia për të bashkëpunuar me organizatat komunitare dhe me donatorët, qeverinë dhe biznesin ndërkombëtar, është një nga pikat e forta të Milieukontakt.

Ne krijojmë aleanca strategjike dhe partneritete me organizatat e shoqërisë civile, autoritetet, bizneset dhe institucionet ndërkombëtare aktive për zhvillimin e qëndrueshëm ose çështje të tjera që lidhen me këtë temë si gjinia, shëndetësia dhe arsimiti.

Ne zhvillojmë, përdorim dhe lehtësojmë metodat e pjesëmarrjes, shkëmbimin e informacionit, analizën dhe veprimtarinë midis palëve të interesuara dhe lidhim këtë qasje me zgjidhje praktike, me kosto efektive dhe të qëndrueshme për sfidat mjedisore. Ne bashkëpunojmë me shkencëtarë (social) dhe institucione kërkimore për të hulumtuar, analizuar dhe zhvilluar më tej qasjen e Milieukontakt dhe metodat e punës. Ne do të zbatojmë në punën tonë të përditshme kodin tonë të sjelljes me rregullat për sjellje për të luftuar korrupsionin në projekte dhe partneritete.

TRANSPARENCA DHE PASQYRAT FINANCIARE

Grafiku i parë tregon fondet sipas burimeve të financimeve për vitin 2023, ku fondet nga organizatat vendase (39.2%) dhe burimet nga projekte me organizata të huaja (38.5%) zenë një peshë gati të barabartë dhe fondet nga BE zenë 22.3% të totalit.



Grafiku i dytë tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2023. Sipas shpenzimeve të kryera rezulton se 37% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, 36% për paga dhe sigurime, 21% ekspertizë dhe 6.2% për publikime dhe shpenzime administrative zyre.

Shpërndarja e buxhetit për vitin 2023

